



Etugert Llazi është Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) që nga muaji nëntor 2025.

Para këtij pozicioni, ka shërbyer si këshilltar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke kontribuar në analizën ekonomike dhe në çështje të lidhura me buxhetin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Ai ka mbajtur gjithashtu pozicione të tjera drejtuese në administratën publike. Një nga angazhimet më të rëndësishme të tij ka qenë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku ka drejtuar Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike. Në këtë rol, ka qenë i përfshirë në planifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e projekteve të investimeve publike, duke kontribuar në përmirësimin e proceseve dhe në koordinimin me financimet e brendshme dhe të huaja.

Më herët, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Rimbursimit të TVSH-së, ku ka drejtuar proceset e rimbursimit dhe ka punuar për përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve ligjore. Gjithashtu, në Institutin e Statistikave (INSTAT), ka mbajtur pozicionet Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Drejtor i Statistikës së Bujqësisë dhe Mjedisit. Në këto funksione, ai ka qenë i angazhuar në zhvillimin e statistikave zyrtare dhe përmirësimin e metodologjive në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Paralelisht me angazhimin në administratë, ai ka kontribuar edhe në mësimdhënie në Universitetin Europian të Tiranës dhe vazhdon të kontribuojë në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në fushën e statistikës.

Etugert Llazi zotëron një Master Shkencor në Studime Ekonomike Europiane dhe një diplomë universitare në ekonomi, si dhe po ndjek studimet e doktoraturës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës.